

## **RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË NGA AUDITUESI I PAVARUR**

**Mbi Pasqyrat Financiare të përgatitura  
për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë  
“GOLDEN KEY”shpk**

|                                                                         |   |
|-------------------------------------------------------------------------|---|
| RAPORT I DHËNIES së SIGURISË i AUDITUESIT të PAVARUR .....              | 1 |
| Pasqyra e lëvizjeve të Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë .....       | 4 |
| Pasqyra e lëvizjeve në llogaritë e Kapitaleve të Veta të Shoqërisë..... | 5 |
| 1. Të dhëna të përgjithshme.....                                        | 6 |
| 2. Kapitallet e Veta dhe zmadhimi i Kapitalit të Nënshkruar.....        | 6 |
| 3. Politikat Kontabël për pasqyrimin e Kapitaleve të Veta.....          | 7 |

## **RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË NGA AUDITUESI I PAVARUR**

**Drejtuar :**

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË "GOLDEN KEY" SH.P.K"**

### **Qëllimi i Angazhimit:**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me vendim datë 07.12.2023 më ka angazhuar si auditues ligjor, për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të veprimeve kontabël, në funksion të zmadhimit të kapitalit lidhur me parashikimin e paraqitur në pikën 1 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 07.12.2023, si dhe përcaktimin e vlerës së kapitalit të zmadhuar, si rezultat i ngjarjes së parashikuar në Vendimin (dhe pikën) e sipërcituar. Për këtë qëllim, unë kam rishikuar Pasqyrat Financiare të përgatitura për qëllim të analizimit të lëvizjeve të kapitalit të shoqërisë, të cilat përfshijnë ; (i) *Pasqyrën e Lëvizjeve të Kapitalit të Nënshkruar* për periudhën që mbaron më 31 Dhjetor 2022 dhe periudhën që mbaron më 30 Nëntor 2023, (ii) *Pasqyrën e llogaritjeve të vlerës së pjesëve të reja në qoftë se Asambleja e Përgjithshme pranon zmadhimin e kapitalit të nënshkruar.*

### **Kriteret**

Si bazë për angazhimin e verifikimit të lëvizjeve të kapitalit, ne kemi përdorur Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar, Ligjin Nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ne jemi njohur dhe kemi verifikuar edhe Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë datë 07.12.2023, si dhe konsideratat e bëra nga administrimi i shoqërisë për qëllim të zmadhimit të kapitalit.

### **Përgjegjësia e Drejtimit**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të ortakëve, kryerjen e llogaritjeve dhe pasqyrimin e drejtë të kuotave që i takojnë ortakëve të shoqërisë në momentin e zmadhimit apo zmadhimit të kapitalit.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e Asamblesë me rend dite ndryshimin e kapitalit.

### **Përgjegjësia jonë**

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim. **Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike"** dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë.

Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet e përgatitura nga drejtimi i Shoqërisë për kaptalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale si dhe cdo informacion tjetër kontabël në funksion të çështjes.

### **Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:**

1. Verifikimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me vendimmarrjet e ortakëve për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.
2. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në Pasqyrën e Kapitaleve të Veta me ato të Pasqyrave Financiare, të vitit ushtrimor mbyllur më 31 Dhjetor 2022, identikisht edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur më 30 Nëntor 2023 (paraprake).
3. Verifikimin e financimeve apo tërheqjeve të mundshme që mund të jenë kryer nga Ortakët e Shoqërisë, dhe që lidhen qartësisht dhe vetëm me kapitalin, nga data e e themelimit të Shoqërisë deri në datën 30 Nëntor 2023.
4. Verifikimin e llogaritjeve për vlerën e kuotave të Ortakëve, si efekt i zmadhimit të kapitalit të nënshkruar, nese pranohet ky Raport.

### **Konkluzioni:**

1. Bazuar në procedurat e kryera, vlera e kapitalit të nënshkruar (dhe të paguar) është 100,000 Lekë dhe paraqitet e pandryshuar që nga themelimi i shoqërisë. Kjo vlerë rakordon me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që unë verifikova. Pasqyra Financiare e Kapitaleve të Veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë, si dhe shënimet e lidhura me to, japin një pasqyrim të sinqertë dhe të vërtetë të gjendjeve të Kapitaleve të Veta për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, po ashtu edhe më 30 Nëntor 2023 (paraprake).
2. Nga analiza e Pasqyrave Financiare 2022 dhe atyre paraprake deri më 30 Nëntor 2023, rezulton se Shoqëria ka aktive fikse dhe qarkulluese në vlera të konsiderueshme, si rrjedhojë e aktivitetit ekonomik të saj.
3. Ortakët e Shoqërisë bien dakort që të zmadhojnë kapitalin e nënshkruar nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë në vlerat sipas pikës 4 më poshtë.

4. Pas vendimarrjes së Asamblesë për realizimin e rritjes së kapitalit, vlera e kuotës së kapitalit për secilin ortak dhe përqindja në kapitalin e shoqërisë do të rezultonte si më poshtë :

| <b>Ortaku</b>   | <b>Nr. i kuotave</b> | <b>Vlera e kuotës</b> | <b>% në kapital</b> |
|-----------------|----------------------|-----------------------|---------------------|
| Bardhjus Bushaj | 1                    | 17,500,000            | 50%                 |
| Erion Gina      | 1                    | 17,500,000            | 50%                 |
| <b>Totali</b>   | <b>2</b>             | <b>35,000,000</b>     | <b>100%</b>         |

*Migela XHANI*

**MIGELA XHANI**  
**EKSPERT KONTABEL**  
**TIRANE**

AUDITUESE LIGJORE

Tiranë më, 22.12.2023

**PASQYRA E LËVIZJEVE TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQËRISË**

**Për periudhën 31 Dhjetor 2022 deri më 30 Nëntor 2023**

| <b>Përshkrimi</b>     | <b>Shuma sipas Pasqyrave<br/>Financiare 31.12.2022</b> | <b>Shuma që do të përdoret për<br/>zmadhimin e kapitalit</b> | <b>Shuma e kapitalit pas realizimit të<br/>zmadhimit të kapitalit</b> |
|-----------------------|--------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| Kapitali i nënshkruar | 100,000                                                | 34,900,000                                                   | 35,000,000                                                            |

**PASQYRA E ANALITIKE E LLOGARITJEVE TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQËRISË**

**Për periudhën 31 Dhjetor 2022 deri më 30 Nëntor 2023**

|                                                   | <b>Totali</b>     | <b>Ortaku<br/>Bardhjus Bushaj</b> | <b>Ortaku<br/>Erion Gina</b> |
|---------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------|------------------------------|
| Kapitali i nënshkruar ekzistues                   | 100,000           | 50,000                            | 50,000                       |
| Shtesa e Kapitalit                                | 34,900,000        | 17,450,000                        | 17,450,000                   |
| <b>Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit</b>         | <b>35,000,000</b> | <b>17,500,000</b>                 | <b>17,500,000</b>            |
| Numri i pjesëve                                   | 2                 | 1                                 | 1                            |
| Vlera e pjesës                                    | 35,000,000        | 17,500,000                        | 17,500,000                   |
| <b>Pjesëmarrja në përqindje</b>                   | <b>100%</b>       | <b>50%</b>                        | <b>50%</b>                   |
| Shuma që do të përdoret për zmadhimin e kapitalit | 34,900,000        | 17,450,000                        | 17,450,000                   |
| Shuma e paguar deri më 30.11.2023                 | -                 | -                                 | -                            |
| <b>Shuma që mbetet për t'u paguar</b>             | <b>34,900,000</b> | <b>17,450,000</b>                 | <b>17,450,000</b>            |

## **1. Të Dhëna të Përgjithshme**

GOLDEN KEY sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") është një shoqëri e krijuar më 19.07.2021 dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit duke u pajisur me NUIS M11926008G.

Aktiviteti i Shoqërisë është : Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi; rrugë; ura; porte; trase hekurudhore; terminale; hidrocentrale; veprave bonifikuese; parkimeve nëntokësore dhe çdo ndërtim tjetër; punime ndërtimore në nëntokë dhe në lartësi. Rikonstruksion i ndërtimeve civile dhe restaurime të objekteve historike, fetare dhe objekteve të tjera. Studim, projektim i ndërtimeve të ndërtesave publike, rrugëve, urave, tuneleve, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese, centrale, objekte turistike, terminale, parkime nëntokësore, industriale, objekte të kulleve, realizim të studimeve urbane, restaurime, prodhim të materialeve të ndërtimit. Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive të paluajtshme. Aktivitet në menaxhimin e qendrave të biznesit; qendrave tregtare; terminaleve; porteve; aeroportëve; dhe shërbimeve të ngjashme. Aktivitet në fushën e financimit, investimit dhe menaxhimit të projekteve koncesionare; partneritet publik privat; partneritetit duke krijuar shoqëri të thjeshta; partneritet me shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja. Prodhim dhe tregtim materiale ndërtimi, inerte, rërë, mermer, etj. Prodhim dhe tregtim makineri e pjesë këmbimi për llojet e ndryshme të makinerive. Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj duke përfshirë edhe veprime për shitblerje sendesh të luajtshme e të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera. Blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve, bono, të letrave me vlerë të borxhit publik dhe privat në përgjithësi, të aksioneve në kompani, letra me vlerë, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive të paluajtshme. Ushtrimin e aktiviteteve si bar lokale dhe furnizimin me produkte ushqimore dhe pije, si aktivitet tregtar. Në ushtrimin e këtyre aktiviteteve kompania mund të përdorë degë, zyra, agjenci dhe depo në të gjithë vendin si edhe jashtë vendit. Shoqëria mund të përmbushë të gjitha operacionet tregtare, në fushën e pasurive të paluajtshme, financiare dhe industriale që do të konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ ose të dobishme për të arritur qëllimin e shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, dhe të pasurive të paluajtshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, të marrë pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe të japë garanci për hua si dhe garanci hipotekore në favor të ortakëve dhe në favor të të treteve.

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë aktualisht është 100,000 lekë dhe zotërohet në mënyrë të barabartë nga dy ortakë z. Bardhjus Bushaj dhe z. Erion Gina, në raportin 50% / 50%.

Administratori i Shoqërisë është z. Ardjan Kollozi.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rr. "Elbasanit", Godina "Lion Residence", Kati 0.

## **2. Kapitalet e Veta dhe ndryshimet në Kapitalin e Nënshkruar**

Ortakët nuk kanë ndërmarrë veprime në lidhje me ndryshimin e kapitalit të nënshkruar, që kur Shoqëria është themeluar.

Aktualisht kapitali i regjistruar figuron në QKB dhe në pasqyrat Financiare të Shoqërisë, në vlerën 100,000 lekë.

### **3. Politikat Kontabël për pasqyrimin e Kapitaleve të Veta**

#### **a. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Ligjin Nr.25/2018 dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

#### **b. Monedha Funksionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase ALL (Lek), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e shoqërisë. Informacioni financiar është paraqitur në Lek.

#### **c. Huatë**

Huamarrjet nga ortakët maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar, përveçse në rastet kur shoqëria zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.